



PUKË

**POP**  
**2019**

**PERBALLJA**  
**OFERTAVE**  
**POLITIKE**



# KONTRATA SOCIALE



Rr. "Abdyl Frasheri"  
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



[gadc@gadc.org.al](mailto:gadc@gadc.org.al)



+355 4 22 555 14



[www.popalbania.info](http://www.popalbania.info)



+355 68 20 59 301



+355 4 22 555 14

## PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA PUKË 23.10.2019

- **Prioritet 1:**  
Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të priorizojnë grupet më pak të avantazuara në tregun e punës:
  - Të rinjtë e sapo diplomuar.
  - Gratë.
  - Gratë viktime të dhunës në familje.
- **Prioritet 2:**  
Adresimi me prioritet i rregullimit të rrugëve në nivel bashkie.
- **Prioritet 3:**  
Adresimi me prioritet i vendosjes së transportit publik, sidomos në ato zona i cili mungon totalisht.
- **Prioritet 4:**  
Adresimi dhe listimi prioritar për ngritjen e shërbimeve për grupe në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.
- **Prioritet 5:**  
Ngritja e programeve dhe organizimi i fushatave ndërgjegjësuere kundër dhunës me bazë gjinore.
- **Prioritet 6:**  
Unifikimi i shërbimit dhe cilësisë së pastrimit për të gjitha zonat që janë pjesë e bashkisë Pukë. Shtimi i koshave në njësitë administrative dhe zonat periferike ku mungojnë dhe kontroll më i shpeshtë nga bashkia.
- **Prioritet 7:**  
Adresimi dhe rregullimi i furnizimit me ujë të shkollave si dhe rregullimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe kontrolli i cilësisë së tij nëpër fshatra.
- **Prioritet 8:**  
Buxhetim me pjesëmarrje në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrjen mbi menaxhimin e financave publike të pushtetit lokal.
- **Prioritet 9:**  
Ngritja e akademisë sportive (zhvillimi i shumësporteve për aktivizimin rinor)
- **Prioritet 10:**  
Lobimi dhe mbështetja nga bashkia në lidhje me bursat e ekselencës
- **Prioritet 11:**  
Nevoja për hapjen e kurseve profesionale me bazë zhvillimin e aftësive për turizëm si një fushë prioritare e zhvillimit të Pukës duke sjellë kështu edhe rritjen e punësimit të të rinjve dhe grave.
- **Prioritet 12:**  
Zhvillimi dhe identifikimi i zonave turistike, tabelat informuese, shtigjet malore, informacion i zgjeruar për zhvillimin e zonës së Pukës.
- **Prioritet 13:**  
Kërkesa për të hapur një qendër rinore.
- **Prioritet 14:**  
Rishikimi i ndihmës ekonomike veçanërisht për gratë kryefamiljare, të divorcuara dhe ato të dhunuara.

